

VENDIM
Nr. 321, datë 19.4.2013

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR
KRYEMINISTRINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Integritit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryeministrisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, zëri “Shpenzime korrente”, t’i shtohet fondi prej 40 000 000 (dyzet milionë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve, për shërbimet e kërkimit në fushën ligjore dhe të lobizmit, të cilat do të shërbejnë për forcimin e marrëdhënieve midis institucioneve të Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dhe atyre të vendeve të tjera, si dhe identifikimin e tërheqjen e financimeve nga agjenci të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe agjenci të tjera ndërkombëtare dhe të investimeve në fusha me interes.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Kryeministria për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha